



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E MATURËS SHTETËRORE
(Provim i detyruar për gjimnazet)

LËNDA: GJUHË E HUAJ
(I RISHIKUAR)

VITI MËSIMOR 2019 – 2020
KORDINATORE:LUDMILLA STEFANI
PRILL 2020

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	3
II.	GJUHA E HUAJ NË MATURËN SHETËRORE.....	4
III.	UDHËZIME PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT	6
IV.	STRUKTURA E TESTIT.....	7
V.	REZULTATET E TË NXËNIT PËR SECILËN AFTËSI	9
VI.	TIPET E USHTRIMEVE TË REKOMANDUARA.....	10
VII.	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	12
VIII.	NJOHURITË QË NUK DO TË PËRFSHIHEN NË PROVIMIN E MATURËS SHETËRORE 2019-2020.....	14

I. HYRJE

Pandemia COVID-19 ka prekur çdo fushë të veprimtarisë njerëzore dhe të gjithëve na është dashur të përshtatemi me një ndryshim të papritur në mënyrën se si jetojmë. Ky ndryshim natyrisht ka përfshirë edhe arsimin.

Shumica e vendeve në Evropë dhe më gjerë i kanë mbyllur institucionet arsimore për të kufizuar kontaktin mes njerëzve dhe për të parandaluar përhapjen e virusit. Edhe në vendin tonë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) i ka mbyllur institucionet arsimore që nga data 9 mars 2020.

Gjatë kësaj periudhe, MASR po mbështet mësuesit në përpjekjet e tyre për të realizuar procesin mësimor në kushtet e shtëpisë. Dy format kryesore mësimore që po zbatohen, janë mësimet të xhiruara dhe të transmetuara në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH) dhe puna mes nxënësve dhe mësuesve përmes rrjeteve sociale apo përmes platformave të ndryshme që mundësojnë krijimin e klasave virtuale (google classroom, google hangout, edmodo, zoom etj.). Këto janë format me të cilat kanë punuar të gjithë nxënësit, përfshirë edhe maturantët.

Për t'u ardhur në ndihmë maturantëve, ASCAP ka hartuar urdhrin nr.43, datë 22.04.2020, "Për rishikimin e programeve orientuese për provimet e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2019-2020, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19". Bazuar në urdhrin e mësipërm janë reduktuar nga programi orientues, njohuritë dhe aftësitë lëndore që janë zhvilluar gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë dhe që përkojnë me periudhën mars-qershor 2020. Njohuritë dhe aftësitë që janë reduktuar, janë pasqyruar në rubrikën e fundit të këtij programi. Këto njohuri dhe aftësi nuk do të përfshihen në testin e gjuhës së huaj në provimin e Maturës Shtetërore.

Procesi i rishikimit të programit orientues është realizuar nga specialistët e kurrikulës në ASCAP në bashkëpunim me mësues të gjuhës së huaj.

II. GJUHA E HUAJ NË MATURËN SHTETËRORE

Programi orientues për përgatitjen e provimeve të maturës shtetërore për lëndën gjuhë e huaj, vjen si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë.

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në dokumentet kurrikulare për lëndën gjuhë e huaj duke pasur parasysh zhvillimin e aftësive gjuhësore që do të testohen si dhe programet e tri viteve të gjimnazit.

Ky program orientues synon:

- të ndihmojë nxënësit në përgatitjen e tyre për provimin e Maturës Shtetërore në lëndën gjuhë e huaj, duke ju referuar programit të klasës 12-të të gjuhës së huaj të parë , si edhe Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët;
- të ndihmojë mësuesin e lëndës, për t'u dhënë orientimet e duhura nxënësve dhe për të punuar për zbatimin e programit ;
- vlerësimin e njëkohshëm të 2 aftësive kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj) që përbëjnë dhe **dy konceptet bazë**, që janë të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim;
- të japë orientime për mësuesit hartues të testeve të provimit të maturës shtetërore për gjuhën e huaj të parë;
- vlerësimin e të kuptuarit dhe të shprehurit, duke mbajtur parasysh formimin e njohurive dhe shprehive të domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale si dhe arritjen e rezultateve të të nxënit për nivelin përkatës në zbatim të kurrikulës me kompetenca të lëndës së gjuhës së huaj të arsimit të mesëm të lartë;
- aftësinë për të përdorur formimin gjuhësor në mënyrë të pavarur, korrekte dhe të përshtatshme me situata komunikimi të dhëna.

Bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore, testi i gjuhës së huaj hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor trajtohet si gjuhë e huaj e parë dhe niveli i njohurive synohet të jetë B2, sipas “Kuadrit të Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët”.

Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit B2 i cili i referohet shkallës globale të “Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët”.

Përdorues i pavarur	B2	<p><i>Nxënësi:</i></p> <p><i>mund të kuptojë idetë kryesore të një teksti kompleks mbi çështje konkrete dhe abstrakte, duke përfshirë diskutime teknike në fushën e tij/saj të specializimit ;</i></p> <p><i>mund të bashkëveprojë rrjedhshëm dhe spontanisht, duke e bërë komunikimin me folës vendas, të mundshëm, pa vështirësi për secilën palë ;</i></p> <p><i>mund të prodhojë një tekst të qartë, të detajuar rreth një sërë temash dhe shpjegojë pikëpamjet e tij/saj për një çështje të ditës, duke dhënë avantazhe dhe disavantazhe për opsione të ndryshme.</i></p>
----------------------------	----	--

III. UDHËZIME PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT

Për përdorimin e këtij programi, mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, pasi nxënësi në provim do të përballet me pjesë të reja leximi, megjithëse tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që ka studiuar ndër vite.

Kur flitet për tematikën kryesore në program, nxënësit duhet të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program nga **jeta e përditshme, bota e shkollës dhe e punës, jeta personale dhe shoqërore, bota rreth nesh, bota e komunikimit** etj.

Për sa i përket gramatikës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore, të studioara gjatë shkollimit dhe t'i përdorin ato në mënyrë të pavarur e në kontekst të një situatë të re.

Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktike të trajtimit të strukturave gramatikore nëpërmjet ushtrimeve të shumëllojshme të dhëna në tekstin shkollor, fletoren e punës dhe më gjerë.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës të cilat trajtohen në nivelin B2.

Për sa i përket të shkruarit, mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit të jenë të aftë të përmbushin kërkesat e nivelit përkatës gjuhësor përmes të shkruarit të një letre/e-mail, eseje, prezantimi, përshkrimi ose tregimi.

IV. STRUKTURA E TESTIT

Testi i gjuhës së huaj ndërtohet mbi bazën e dy aftësive dhe vlerësimin e njëkohshëm të tyre që janë të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim.

Nëpërmjet testit të lëndës “Gjuhë e huaj” në Provimin e Maturës Shtetërore, nxënësi do të vlerësohet për realizimin e kompetencave gjuhësore.

KOMPETENCAT E LËNDËS “GJUHË E HUAJ”	PËRSHKRIMI I KOMPETENCAVE
Kompetenca gjuhësore	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• zotëron fjalor të pasur për tema të përgjithshme dhe ato që lidhen me fushën e tij të interesit ;• përdor formulime të ndryshme fjalish për të shmangur përsëritjet por akoma mund të vihen re moment hezitimi, saktësia gjuhësore është në përgjithësi e lartë megjithëse mund të shfaqen momente konfuzioni pa ndikuar në komunikim;• tregon shkallë të lartë kontrolli gramatikor duke mos bërë gabime të cilat mund të çojnë në keqkuptime;• shkruan në mënyrë inteligjente tekste të gjatë dhe të qartë duke zbatuar strukturën standarde të organizimit të paragrafëve dhe të gjithë tekstit. Drejtshkrimi dhe pikëzimi janë të saktë por mund të ketë shenja të influencës së gjuhës amtare.
Kompetenca socio-gjuhësore	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• me pak përpjekje përdor shprehjet idiomatike sipas regjistrave të ndryshëm të gjuhës;• zgjidh situata të ndryshme në dialogë mbi tema nga jeta e përditshme, personale dhe ajo në shkollë, duke u shprehur në mënyrë të përshtatshme dhe pa gabime në formulimin e ideve.

Kompetenca pragmatike	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • fillon, vazhdon dhe përmyll një pjesë të shkruar në mënyrë efektive duke përdorur fjalët lidhëse përkatëse në mënyrë të përshtatshme; • tregon ose përshkruan në mënyrë të qartë duke zgjeruar dhe mbështetur pikat kryesore me shpjegime dhe shembuj të detajuar; • përdor mjete të kufizuara lidhëse për të realizuar të folur të qartë dhe koherent.
-----------------------	--

Përmbushja e kompetencave gjuhësore që një nxënës duhet të zotërojë në përfundim të shkollës së mesme , klasa XII në nivelin B2 janë sipas tabelës më poshtë:

Aftësitë gjuhësore që do të vlerësohen	Përqindja
Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar	50%
Përdorimi i drejtë i gjuhës (gramatika dhe leksiku)	25%
Të shkruarit	25%

V. REZULTATET E TË NXËNIT PËR SECILËN AFTËSI

Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• lexon artikuj dhe raporte të ndryshme që kanë lidhje me probleme bashkëkohore ku autorët e këtyre pjesëve përshtatin qëndrimin dhe këndvështrimin e tyre;• kupton pjesë letrare dhe jo-letrare bashkëkohore;• lexon dhe kupton përmbajtjen dhe gjen thelbin e një informacioni, të një artikulli apo një reportazhi me një gamë të gjerë temash .
Përdorimi i drejtë i gjuhës
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• përcjell mesazhin me shkrim nëpërmjet strukturave të përbëra gjuhësore dhe gramatikore duke i përdorur ato saktë dhe pa gabime ortografike;• ka një gamë të gjerë të fjalorit për tema lidhur me fushën e tij të interesit;• mund të ndryshojë formulimin e tij për të shmangur përsëritje të shpeshta, por mangësitë leksikore mund të shkaktojnë ende hezitime dhe përdorime të perifrazave;• ka një kontroll të mirë mbi aspektin gramatikor; bën gabime të rastësishme dhe jo sistematike, bën rrallë gabime sintaksore duke e korrigjuar veten;• duke pasur një kontroll të mirë gramatikor, nuk bën gabime që të çojnë në keqkuptime.
Të shkruarit
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• shkruan ese përshkuese dhe informuese duke theksuar në mënyrë të përshtatshme pikat e rëndësishme dhe hollësitë e spikatura që e mbështesin atë;• vlerëson idetë e ndryshme ose zgjidhjet e një problemi;• sintetizon informacione dhe argumente të marra nga burime të ndryshme.

VI. TIPET E USHTRIMEVE TË REKOMANDUARA

Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar
<p>Përshkrimi: Vlerësimi i kësaj aftësie do të bëhet mbi bazën e disa teksteve të panjohura me tema aktuale që lidhen me interesat e të rinjve mbi të cilat do të ndërtohen pyetje që do të testojnë aftësinë e nxënësit për të kuptuar një pjesë letrare ose jo letrare apo gjini tjetër e të shkruarit (reklama, informacione, letra, pjesë nga broshura të ndryshme turistike, etj.)</p> <p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje, të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar informacionin e dhënë në pjesën e leximit, të mbledhë informacionet që i kërkohen rreth tekstit apo të japë një vlerësim ose opinionin e tij, të mbështetur mbi fakte në pjesën që lexon.</p>
<ul style="list-style-type: none">• pyetje mbi idenë kryesore të tekstit;• pyetje mbi kuptimin e përgjithshëm të tekstit;• pyetje për të shpjeguar shkakun e një ngjarjeje në tekst;• pyetje mbi informacione specifike në tekst; • pyetje mbi detaje të ndryshme që dalin në tekst; • pyetje për gjetjen e kuptimit të fjalëve nga konteksti;• plotësimi i vendeve bosh me informacionin e duhur;• ushtrime me përgjigje <i>po/jo</i>;• pyetje të hapura me përgjigje të shkurtër ose të strukturuar mirë;• ushtrime me disa alternativa (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 alternativat);• vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve;• pyetje rreth mendimit personal të nxënësit për problemet e trajtuara në tekst (mendimi kritik).
Përdorimi i drejtë i gjuhës
<p>Përshkrimi: Njohuritë kryesore që nxënësi ka marrë mbi përdorimin e gjuhës ndër vite, do të testohen përmes ushtrimeve që e shohin gramatikën dhe leksikun si pjesë të integruara në situata të gjuhës së përdorur në përditshmëri; pra si një gjuhë funksionale.</p>
<ul style="list-style-type: none">• ushtrime me plotësime hapësirash ku nxënësi duhet të vendosë fjalën ose njësinë e duhur gramatikore. Ushtrimi ndërtohet mbi një tekst të shkurtër ose paragraf me një temë të caktuar. Gramatika dhe leksiku ndërthuren bashkë në atë çka i kërkohet nxënësit të plotësojë;• ushtrime me zgjedhje alternativash;• ushtrime me plotësime vendesh bosh në dialogë me tema nga jeta e përditshme;

- ushtrime me plotësime hapësirash, ku nxënësi duhet të vendosë fjalën ose njësinë e duhur gramatikore, ku fjalët që i duhet të vendosë i jepen në një listë dhe nga kjo listë ai gjen fjalën ose njësinë e duhur gramatikore për të plotësuar tekstin apo paragrafin në mënyrë që ai të jetë i saktë;
- situata komunikimi me hapësira bosh, të cilat duhet të plotësohen nga nxënësi me fjalët e tyre. Nxënësit do t'i duhet ta plotësojë situatën komunikative me fjalë dhe aspekte gjuhësore që mungojnë, duke e bërë atë të plotë e me kuptim.

Të shkruarit

Përshkrimi:

Nxënësi mund të prodhojë me shkrim një tekst të detajuar rreth temave me subjekte që lidhen me fushën e tij të interesit, duke shpjeguar këndvështrimin e tij rreth temës.

- ese informuese ose përshkrues;
- shkrimi i një letre/email jo formal.

VII. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Nxënësit në provim do të përballlet me situata ose pjesë të reja leximi, por *tematika*, *gramatika* dhe *funksionet gjuhësore* do të jenë ato që nxënësit kanë studiuar për këtë nivel gjuhe, (B2).

Tematikat me të cilat do ndeshen në provimin e maturës shtetërore do të përfshijë temat bazë sipas kurrikulës dhe “Kudrit Evropian të Referencave për Gjuhët” i cili së bashku me Portofolin Evropian të Gjuhëve janë materialet referues për të gjitha gjuhët që mësohen në sistemin tonë parauniversitar.

- **Jeta e përditshme** (*organizimi i një plani ditor dhe i kohës së studimit; kujtime të mrekullueshme; dita më e bukur e jetës sime; qëllimet afatshkurtër dhe afatgjatë; çfarë dua unë për të ardhmen time; etj.*)
- **Bota e shkollës dhe e punës** (*organizimi i një biznesi të vogël; shqetësimet e shoqërisë së sotme si papunësia etj; etj.*)
- **Jeta personale dhe shoqërore** (*shanse dhe të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, të rinjtë dhe të rriturit; vendlindja; personalitete në shoqëri; etj.*)
- **Bota rreth nesh** (*arti në shekuj; e ardhmja, flora dhe fauna; programet televizive; zakonet dhe traditat në vendet ku flitet gjuha që po mësohet; etj.*)
- **Bota e komunikimit** (*bota e teknologjisë; rrjetet sociale; të shkruarit e letrave; letër kërkesë, letër ankesë, letër biznesi, ese; etj.*)

Përdorimi i gjuhës do trajtojë:

a) Elementet dhe strukturat gramatikore. Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore, sugjerohet të punohet në mënyrë të përqendruar mbi strukturat dhe çështjet gramatikore më të rëndësishme të trajtuara sipas specifikave të çdo gjuhe të nivelit B2, duke përjashtuar ato njohuri që nuk u morën gjatë muajve mars-prill-maj. Duhet patur parasysh se, gjuha e huaj në klasën e 12 është një rimarrje njohurish përsa i përket njohurive gramatikore dhe funksioneve gjuhësore.

- *ndajfoljet e mënyrës, kohës etj; mbiemrat dhe strukturat e tyre; fjalitë e përbëra; format e përbëra të foljeve në kohë të tashme, të shkuar dhe të ardhme; ligjërata e*

drejtë dhe e zhdrejtë në format e përbëra të foljeve; mënyra jo veprorë në format e përbëra të foljeve; foljet modale; fjalitë kushtore, nyjet, emrat, etj.

b) *Funksionet gjuhësore* duhet të trajtohen nëpërmjet ushtrimeve të ndërtuara si bashkëbisedime në situata të ndryshme të jetës së përditshme. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur kryesisht për këto situata gjuhësore.

- *dhënia e këshillave; të shprehurit e keqardhjes; theksimi i informacionit; të shprehurit e mendimit ose opinionit personal; vënia në diskutim ose të mos biesh dakord me dikë; sugjerime, ftesa, etj.*

**VIII. NJOHURITË QË NUK DO TË PËRFSHIHEN NË PROVIMIN E MATURËS
SHTETËRORE 2019-2020**

Reading	Grammar	Vocabulary	Writing
<ul style="list-style-type: none"> • Texts on medicine • Text on arts and artists' life • Text on history of England • Text on science and its development • Text on education and universities 	<ul style="list-style-type: none"> • 3rd conditional • Different forms of constructing compound and complex sentences • Difficult forms with modal verbs • Infinitives and ing-forms • Causative forms • Inversion 	<ul style="list-style-type: none"> • Medicine vocabulary • Vocabulary related to different historic ages • Vocabulary related to arts and artists activities • Prepositional phrases • Difficult idiomatic expressions 	<ul style="list-style-type: none"> • Writing an argumentative essay expressing pros and cons on a certain topic. • Writing a report giving suggestions on a topic. • Writing a review of a book or a film. • Writing a formal letter of application.

Compréhension écrite	Grammaire	Le lexique	Production écrite
<ul style="list-style-type: none"> • Texte sur la science et son développement • Texte sur l'art et la vie des artistes et des écrivains. • Texte sur l'histoire, l'émigration ou l'expatriation • Texte sur l'économie • Texte sur la médecine. 	<ul style="list-style-type: none"> • Le subjonctif passé. • Le subjonctif dans les propositions relatives. • Les pronoms relatifs composés. • Les formes pronominales de sens passif. • Les locutions verbales. • La mise en relief. • La question avec inversion. • Le participe présent. • L'inversion du sujet. • Le superlatif. 	<ul style="list-style-type: none"> • Le lexique de la science. • Le lexique spécifique lié à l'art et à des activités artistiques particulières. • Le lexique lié aux différentes époques historiques. • Les expressions familières. • Les expressions idiomatiques ou expressions figées. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ecrire un essai argumenté en s'exprimant pour ou contre sur un sujet donné. • Ecrire un rapport en donnant des suggestions sur le sujet. • Ecrire le résumé d'un livre ou d'un film. • Ecrire une lettre officielle de motivation. • Ecrire la biographie des célébrités

--	--	--	--

Leseverstehen	Grammatik	Wortschatz	Schreiben
---------------	-----------	------------	-----------

Lettura	Grammatica	Lessico	Produzione scritta
<ul style="list-style-type: none"> • Testi sulla medicina • Testi sull'arte e sulla vita degli artisti • Testi sulla storia d'Italia • Testi sulla scienza e sui suoi sviluppi • Testi sull'educazione e l'università 	<ul style="list-style-type: none"> • Il periodo ipotetico di terzo tipo • Le diverse forme di costruzione di frasi composte e complesse • Forme difficili con i verbi modali • Le forme composte dell'infinito e del gerundio • Le forme complesse della trasformazione di una frase dal discorso diretto in quello indiretto. 	<ul style="list-style-type: none"> • Il linguaggio della medicina • Il lessico legato a diversi periodi storici • Il lessico che riguarda l'arte e l'attività degli artisti • Difficili espressioni idiomatiche 	<ul style="list-style-type: none"> • Scrivere un saggio argomentativo esprimendo i pro e i contro su un tema specifico. • Scrivere un rapporto in cui si danno suggerimenti su un tema specifico • Scrivere il riassunto di un libro o di un film. • Scrivere una lettera formale di candidatura.

<ul style="list-style-type: none"> • Texte zur Medizin • Texte zur Kunst • Texte zur deutschen Geschichte • Texte zur Wissenschaft und Forschung • Texte zur Bildung und Universität 	<ul style="list-style-type: none"> • Modale Zusammenhänge • Subjektlose Passivsätze • Erweitertes Partizip • Adversativsätze • Partizipien als Nomen • Konditionalsätze 	<ul style="list-style-type: none"> • Medizinische Wortschatz • Wortschatz in Bezug auf verschiedene historische Zeitalter • Wortschatz in Bezug auf Kunst und künstlerische Aktivitäten • Schwierige Redewendungen und Ausdrücke 	<ul style="list-style-type: none"> • Argumente und Gegenargumente für oder gegen einen bestimmten Standpunkt darlegen. • Berichte schreiben • Eine Rezension zu einem Buch oder Film. • Eine Bewerbung schreiben
---	---	--	--